

**Informacione të rëndësishme rreth vaksinimit të COVID-19 në Kantonin e Zyrihut**

Kush mund ta marrë vaksinimin?	<ul style="list-style-type: none">• Personat e moshës 75 vjeç e lart• Të rriturit me forma veçanta dhe të rënda të sëmundjeve të zemrës, të frymëmarrjes dhe të veshkave, me presion të lartë të gjakut, diabet, obezitet dhe mungesë të imunitetit (sipas Impfempfehlung EKIF [rekomandimeve për vaksinimin të Komisioni Federal për Çështjen e Vaksinimit]).
Përse të tjerët nuk kanë mundësi të vaksinohen?	<ul style="list-style-type: none">• Në fillim ka vetëm pak vakcina në dispozicion dhe duhet të jepen me përparësi shumë të përcaktuara.• Kështu që, do të vaksinohen së pari personat e moshës 75 vjeç e lart, si dhe pacientët me rrezik të lartë, sepse janë më të rrezikuar nga COVID-19.
Kush nuk duhet të vaksinohet?	<ul style="list-style-type: none">• Njerëzit që janë alergjikë ndaj ndonjë përbërësi të vaksinës (sidomos ndaj Polyethylenglykole, PEG)• Gratë shtatzëna• Në raste paqartësie, pyesni mjeken/mjekun tuaj të shtëpisë ose Ärztefon-in [Telefonin informativ të mjekëve] (0800 33 66 55).
Si mund të regjistrohem për vaksinimin?	<ul style="list-style-type: none">• Përmes të vebfaqes www.coronazentrum.uzh.ch ose Ärztefon-it (0800 33 66 55)• Pacientët me rrezik të lartë duhen të regjistrohen nga mjekja ose mjeku i tyre.
Ku bëhet vaksinimi?	<ul style="list-style-type: none">• Në Qendrën Referendare të Vaksinimit [Referenz-Impfzentrum] të Qendrës për Mjekësi Udhëtimi [Zentrum für Reisemedizin] në EBPI [Instituti për Epidemiologji, Biostatistikë dhe Parandalim], Hirschengraben 84, 8001 Zürich, mbi stacionin Central, pak minuta prej Hauptbahnhof-it [stacionit kryesor]; hapësira të rezervuara parkimi në dispozicion.
Çfarë duhet të sjell me vete kur të vij të vaksinohem?	<ul style="list-style-type: none">• Kartelën e Sigurimit Shëndetësor• Një dokument personal identifikimi ose një dokument tjetër zyrtar• Dëftesën e vaksinimeve, nëse e keni në dispozicion.
Sa kohë zgjat vaksinimi?	<ul style="list-style-type: none">• Vaksinimi zgjat normalisht rreth gjysmë ore, duke përfshirë një periudhë pushimi prej 15 minutash.• Lejoni kohë të mjaftueshme.



<p>A lirohem pas vaksinimit nga rregullat e përgjithshme të sjelljes që vlejnë për Covid-19?</p>	<ul style="list-style-type: none">• Jo. Akoma nuk dihet nëse vaksinimi i parandalon infektimet. Kështu që mund të ndodhë që të infektoni njerëz të tjerë pavarësisht nga vaksinimi dhe pa pasur ju vetë simptoma.• Prandaj ju lutemi vazhdoni t'u përmbaheni rregullave të higjienës dhe sjelljes.
<p>Çfarë tjetër duhet të di për vaksinimin?</p>	<ul style="list-style-type: none">• Nevojiten dy doza vaksine. Vaksinimi i dytë mund të bëhet jo më herët sesa pas tre javësh. Në fund të vaksinimit të parë, do t'ju jepet takimi për vaksinimin e dytë.
<p>Ku mund të gjej informacione të mëtejshme rreth vaksinimit, në lidhje me vetë vaksinën, si dhe për efektet anësore të mundshme?</p>	<ul style="list-style-type: none">• Vebfaqja e Drejtorisë Shëndetësore të Kantonit të Zyrihut https://www.zh.ch/coronaimpfung• Vebfaqja e EFSh [Enti Federal për Shëndetësinë] https://bag-coronavirus.ch/impfung/• Ärztefon (24h): 0800 33 66 55• Nationale Infoline Covid-19-Impfung [Lidhja telefonike kombëtare informatike rreth vaksinimit Covid-19] (nga ora 06.00 deri në orën 23.00): +41 58 377 88 92.